



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH.nr.831/20**  
**846/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Union”shpk -Vushtrri, si dhe OE “Solution D”shpk - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Baby World” – Lot 1, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me ushqim pluhur për foshnje”, me nr. të prokurimit: 701-20-4188-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK, më datën: 13.11.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Union”shpk -Vushtrri, si dhe OE “Solution D”shpk - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me ushqim pluhur për foshnje”, me nr. të prokurimit: 701-20-4188-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me ushqim pluhur për foshnje”, me nr. të prokurimit: 701-20-4188-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Union”shpk -Vushtri, si dhe OE “Solution D”shpk - Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Union”shpk -Vushtri, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 20.10.2020 me nr. 831/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me ushqim pluhur për foshnje”, me nr. të prokurimit: 701-20-4188-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues “Solution D”shpk - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.10.2020 me nr. 846/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me ushqim pluhur për foshnje”, me nr. të prokurimit: 701-20-4188-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60, 64 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues/ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues /ekspertin teknik të prokurimit në raportin e dt: 04.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1

Përgjigje ne pretendimet ankimore te parashtruara nga OE ankues “Union”:



Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues fillimisht me datën: 22.09.2020, me vendim të AK-se, rekomandohet për kontratë për Lot 1 dhe 2. AK-SHSHKUK-ja, ka pranuar ankese një operator ekonomik dhe pas rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë AK-ja, e shpall të përgjegjshëm OE ankues Union, me arsyetimin se nuk e ka dorëzuar deklaratën nën betim.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Union, lidhur me arsyen e eliminimit pretendon se e ka dorëzuar deklaratën nën betim dhe se AK-ja nuk ka program adekuate për ta hapur atë fajll.

Eksperti shqyrtues, pasi ka ekzaminuar ofertën e OE ankues Union, sqaron se në ofertën e tij ekziston një fajll i cili nuk hapet. Eksperti shqyrtues, sqaron se ka kërkuar edhe ndihmën e TI-se, të cilët kanë provuar që ta hapin edhe në versione dhe aplikacionet tjera, mirëpo ka qenë e pamundur.

Eksperti shqyrtues, pasi që nuk ka mundur të jep një vlerësim lidhur me atë dëshmi, sqaron se OE ankues nëse e ka të mundur të dëshmojë mënyrën se si hapet dhe të njëjtën të ja dëshmojë panelit shqyrtues përmes shkresave dhe njeherit i rekomandojë OE ankues që ti drejtohet KRPP-se për ndonjë sqarim lidhur me atë dëshmi për faktin se e njëjta e menaxhon sistemin e E-prokurimit dhe e njëjta mund të sqarohet nëse ka pasur ndonjë gabim teknik apo pengesa tjera.

## Pretendimi nr. 2

Përgjigje në pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues "Solution D":

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Solution D në vlerësimin e parë ka qenë i përgjegjshëm dhe është njoftuar nga AK-ja si tenderues i pasuksesshëm. Pas rivlerësimit të ofertave AK-ja, e njofton si tenderues të eliminuar.

Në letren standarde të tenderuesit të eliminuar OE ankues eliminohet me arsyetimin se:

Lidhur me pretendimin e AK mbi mos plotësimin e specifikave teknike për produktin NAN OPTIPRO 2

Eksperti Teknik vlerëson se arsyetimi i autoritetit kontraktues mbi vendosjen e limiteve të proteinave nuk është i drejtë. AK thirret në faqen 70 të një punimi të pacituar dhe thirret në legjislacionin evropian dhe në EFSA. Fakti është që përderisa në legjislacionin evropian të vitit 2006 kërkohet që ushqimi pluhur për fëmijë të kenë proteina 1.8g/100kcal – 2g/100kcal (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32006L0141&from=EN>) në vitin 2017 EFSA (Agjencioni Evropian për Sigurinë e ushqimit) ka ndryshuar rekomandimet e veta duke dëshmuar sigurinë e produkteve me sasi prej 1.6g/100kcal (<https://efsa.europa.eu/en/press/news/170511-0>) duke u bazuar në Opinionin Shkencor të panelit të EFSA (<https://efsa.onlinelibrary.wiley.com/doi/epdf/10.2903/j.efsa.2017.4781>).

Pra me rekomandimin me të ri të EFSA (nga linku i bashkangjitur) si dhe nga Opinioni i panelit shkencor të EFSA rekomandimi me të ri mbi nivelin e proteinave është 1.6g/100kcal. Prandaj, eksperti teknik vlerëson se

sipas rekomandimit të fundit të EFSA-se, niveli i proteinave lejohet prej: 1.6g/100kcal dhe në rastin konkret OE ankues ka ofruar me vlerë prej: 1.69g/100kcal.

Lidhur me pretendimin e AK që OE nuk ka ofruar dëshmi shkencore mbi efikasitetin e probiotikut, prebiotikut dhe dyjave së bashku.

Eksperti Teknik vlerëson se pretendimi i AK është i saktë dhe se OE ankues edhe pse i ka në produktin e ofruar, ai nuk ka ofruar punime shkencore lidhur me to, kërkesë kjo e specifikacionit teknik.

Lidhur me pretendimin e AK mbi mos dëshminë e prejardhjes organike.

Eksperti Teknik vlerëson se ky pretendim është i saktë dhe se OE nuk ka ofruar dëshmi mbi prejardhje organike, megjithatë eksperti teknik vlerëson se në kërkesë të DT-se, konkretisht të specifikimi teknik AK-ja, e ka len opsionale, dhe vet fakti që AK-ja e ka lenë opsionale nuk është obligative për OE. Prandaj, kjo arsye e eliminimit nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e AK se OE ankues, nuk ka ofruar dëshmi shkencore mbi benefitet e formulës.

Eksperti Teknik vlerëson se OE ka ofruar dëshmi mbi benefitet e formulës me vlera të ulta të proteinave në parandalimin e mbipeshes (*Adequacy of Infant Formula With Protein Content of 1.6 g/100 kcal for Infants Between 3 and 12 Months; nga Jaime Inostroza, Ferdinand Haschke, Philippe Steenhout, Dominik Grathöhl, Steven E. Nelson, and Ekhard E. Ziegler*); punimi i dytë i ofruar.

Pra kjo arsye e eliminimit të AK-se nuk qëndron plotësisht për faktin se AK-ja, është dashur që kondornenit 72 të LPP-se të kërkojë sqarim shtesë.

OE ankues Solution D, ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë për të cilin pretendon se i njëjti nuk e ka ofruar certifikatën ISO 9001 sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Eksperti teknik sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatën SGS e cila është pjesë e skemës së British Retail Consortium dhe ka të bëjë me sigurinë e ushqimit. Kjo në vetë nuk e përmban dhe nuk është plotësisht kompatible me ISO 9001 përderisa në vetë përmban elementet e HACCP.

Të vetmet standarde të sigurisë në ushqim që përmbajnë të aprovuara nga GFSI (Global Food Safety Initiative) ISO 9001 janë SQF (përfshinë ISO 9001: 1994) dhe FSSC 2200 (përfshinë ISO 22000) (<https://ëëë.iso-9001-checklist.co.uk/is-ISO-9001-GFSI-recognized.htm>).

Sa i përket pretendimit të OE ankues, lidhur me kërkesën e AK-se, ku është kërkuar që Autorizimi nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi (me të dhëna mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, ëëb faqja etj, për mundësi të verifikimit), lidhur me këtë kërkesë OE ankues pretendon se marrëveshja e distribucionit të dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë nuk i përmban të dhëna të kërkesës së dosjes së



tenderit. Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, është dashur të kërkojë sqarim lidhur me këtë dëshmi për faktin se e njëjta nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE-ve ankues të aprovohen si pjesërisht të bazuara, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës për LOT 1 dhe 2 të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues me datë 05.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Union"-Vushtrri me datë 04.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/technik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Union", se AK e ka eliminuar me arsyetimin se nuk e ka dorëzuar deklaratën nën betim kurse pretendon se e ka dorëzuar deklaratën nën betim.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues Union lidhur me arsyen e eliminimit pretendon se e ka dorëzuar deklaratën nën betim dhe se AK-ja nuk ka program adekuat për ta hapur atë fajll. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues pasi ka ekzaminuar ofertën e OE ankues Union, sqaron se në ofertën e tij ekziston një fajll i cili nuk hapet. Është kërkuar edhe ndihma e TI-së nga eksperti shqyrtues, të cilët kanë provuar që ta hapin edhe në versione dhe aplikacionet tjera, mirëpo ka qenë e pamundur.

Përgjigje në pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues "Solution D"

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Solution D", se AK e ka eliminuar me arsyetimin e mos plotësimit të specifikave teknike për produktin NAN OPTIPRO 2.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik vlerëson se arsyetimi i autoritetit kontraktues mbi vendosjen e limiteve të proteinave nuk është i drejtë. AK thirret në faqen 70 të një punimi të pa cituar dhe thirret në legjislacionin evropian dhe në EFSA. Fakti është që përderisa në legjislacionin evropian të vitit 2006

kërkohet që ushqimi pluhur për fëmijë të kenë proteina 1.8g/100kcal – 2g/100kcal

(<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32006L0141&from=EN>) në vitin 2017 EFSA (Agjencioni Evropian për Sigurinë e ushqimit) ka ndryshuar rekomandimet e veta duke dëshmuar sigurinë e produkteve me sasi prej 1.6g/100kcal (<https://ëëë.efsa.europa.eu/en/press/neës/170511-0>)

duke u bazuar në opinionin shkencor të panelit të EFSA

(<https://efsa.onlinelibrary.ëiley.com/doi/epdf/10.2903/j.efsa.2017.4781>).

Pra, me rekomandimin më të ri të EFSA (nga linku i bashkangjitur) si dhe nga Opinioni i panelit shkencor të EFSA, rekomandimi më i ri mbi nivelin e proteinave është 1.6g/100kcal. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik vlerëson se sipas rekomandimit të fundit të EFSA-se, niveli i proteinave lejohet prej: 1.6g/100kcal dhe në rastin konkret OE ankues ka ofruar me vlerë prej: 1.69g/100kcal.

Lidhur me pretendimin e AK-së që OE “Solution D” nuk ka ofruar dëshmi shkencore mbi efikasitetin e probiotikut, prebiotikut dhe dyjave së bashku.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik vlerëson se pretendimi i AK është i saktë dhe se OE ankues edhe pse i ka në produktin e ofruar, ai nuk ka ofruar punime shkencore lidhur me to, kërkesë kjo e specifikacionit teknik.

Lidhur me pretendimin e AK mbi mos dëshminë e prejardhjes organike. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik vlerëson se ky pretendim është i saktë dhe se OE nuk ka ofruar dëshmi mbi prejardhje organike. Megjithatë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik vlerëson se kërkesë të dosja e tenderit, konkretisht të specifikimi teknik AK-ja e ka lënë opsionale dhe vet fakti që AK-ja e ka lënë opsionale nuk është obligative për OE. Prandaj, kjo arsye e eliminimit nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e AK se OE ankues “Solution D” nuk ka ofruar dëshmi shkencore mbi benefitet e formulës. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik vlerëson se OE ka ofruar dëshmi mbi benefitet e formulës me vlera të ulëta të proteinave në parandalimin e mbipeshës (*Adequacy of Infant Formula With Protein Content of 1.6 g/100 kcal for Infants Between 3 and 12 Months*; nga Jaime Inostroza, Ferdinand Haschke, Philippe Steenhout, Dominik Grathöhl, §Steven E. Nelson, and §Ekhard E. Ziegler ); punimi i dytë i ofruar. Pra, kjo arsye e eliminimit të AK-se nuk qëndron plotësisht për faktin se AK-ja është dashur që konform nenit 72 të LPP-së të kërkojë sqarim shtesë.

OE ankues Solution D ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë, për të cilin pretendon se i njëjti nuk e ka ofruar certifikatën ISO 9001 sipas kërkesës së dosjes së tenderit.



Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatën SGS e cila është pjesë e skemës së British Retail Consortium dhe ka të bëjë me sigurinë e ushqimit. Kjo në vete nuk e përmban dhe nuk është plotësisht kompatible me ISO 9001 përderisa në vete përmban elementet e HACCP. Të vetmet standarde të sigurisë në ushqim që përmbajnë të aprovuara nga GFSI (Global Food Safety Initiative) ISO 9001 janë SQF (përfshinë ISO 9001: 1994) dhe FSSC 2200 (përfshinë ISO 22000) (<https://ëëë.iso-9001-checklist.co.uk/is-ISO-9001-GFSI-recognized.htm>).

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Solution D", lidhur me kërkesën e AK-së, ku është kërkuar që autorizimi nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi (me të dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, ëeb faqja etj, për mundësi të verifikimit), lidhur me këtë kërkesë OE ankues pretendon se marrëveshja e distribucionit e dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë nuk i përmban të dhënat e kërkesës së dosjes së tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK-ja është dashur të kërkojë sqarim lidhur me këtë dëshmi për faktin se e njëjta nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se AK nuk ka bërë ekzaminimin, kahsimin dhe vlerësimin e tenderëve në bazë të kriterëve të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të bëjë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK – "SHSKUK";
- 1x1 OE "UNION"-Vushtrri;
- 1x1 OE "SOLUTION D"-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.